



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

KOMISIONI I GARAVE

2022-23

Prishtinë, 10/03/2023

Nr. 150 Dt. 10.03.2023


PRISHTINË • PRISHTINA • PRISTINA

VENDIM Nr. 15/2023

Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të Federatës së Basketbollit të Kosovës, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e vet të mbajtur në datën e lartpërmendur, në përbërje prej Kryesuesit Leart Hoxha dhe anëtarëve Valdet Spahija dhe Ylli Hoti (pjesëmarrje online) shqyrtoi dhe miratoi këto vendime dhe rekomandime:

1. Pas vendimit të Komisionit Arbitrar për kthim në rivendosje, Komisioni miratoi ankesën e KB Vëllaznimi pas ndeshjes me Sigal Prishtinën (xhiro XXIV).
2. Komisioni vendos që ndeshja Vëllaznimi vs Sigal Prishtina (xhiro XXIV) të zhvillohet sërish.
3. Komisioni revokon vendimin nr. 13 dhe vendos që lojtarit Rezart Memed të gregjistrohet për sezonin 2022/23.

Në emër të Komisionit të Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës:


Leart Hoxha
Kryesues i Komisionit



KËSHILLË JURIDIKE:

Palët e pakënaqura me Vendimet e Komisionit të Garave mund të parashetrojnë ankesë pranë Komisionit Arbitrar të FBK-së, në formën dhe brenda afateve të përcaktuara me aktet normative të FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



TEB


Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVES
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA

ARSYETIMI I KOMISIONIT TË GARAVE VENDIMI Nr. 15/2023

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikat 1, 2 dhe 3 të Vendimit Nr.15/2023, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: Në vendimin nr 13 Komisioni i Garave ka vendosur që lojtarit Rezart Memed ti njihet statusi i lojtarit vendor të natyralizuar.

II: KB Vëllaznimi, pas ndeshjes me Vëllaznimi vs Sigal Prishtina, ka bërë ankesë duke pretenduar se Rrezart Memed nuk ka pasur të drejtë loje, në bazë të nenit 31 në Rregullores për Regjistrim dhe Licencim të Klubeve dhe Lojtarëve.

III: Komisioni i Garave në vendimin 14, ka konstatuar se për statusin e lojtarit Rrezart Memed ka vendosur një herë dhe nuk mund të vendosë si shkallë e dytë në vendim të vetin.

IV: KB Vëllaznimi në këtë vendim të Komisionit të Garave është ankuar në Komisionin Arbitrar, që e ka kthyer lëndën në rivendosje dhe ka urdhëruar Komisionin e Garave që ta shqyrtojë ankesën e KB Vëllaznimi në aspekt meritot.

V: Komisioni ka konstatuar se lojtarit Rezart Memed i është konfirmuar statusi i lojtarit vendor të natyralizuar, meqë ai është pajisur me shtetësi dhe dokumente të Republikës së Kosovës. Mirëpo, për shkak të një lëshimi teknik, Komisioni nuk e ka trajtuar të drejtën e lojës së lojtarit në sezonin 2022/23. Pas shqyrtimit të dispozitave për lojtarë të natyralizuar në Rregulloren për Regjistrim dhe Licencim të Klubeve dhe Lojtarëve dhe dispozitave për afate të regjistrimit në Rregulloren për Regjistrim dhe Licencim të Klubeve dhe Lojtarëve dhe në Propozicione të Garave, Komisioni konstaton se lojtari mban statusin e lojtarit të natyralizuar, por vendos si në pikën 3 të dispozitivit.

VI: Pas shqyrtimit të ankesës së KB Vëllaznimi, Komisioni miraton ankesën dhe vendos si në pikat 1 dhe 2 të dispozitivit.

VII: Komisioni kërkon nga Komesari i Garave, që në afatet e parapara në Propozicione të Garave, të caktojë terminin për zhvillimin e sërishëm të ndeshjes.



Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:

